



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 474 prot.

Tiranë, më 26.03.2026

URDHËR

Nr. 20, datë 26/03/2026

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT INSTITUCIONAL TË TRANSPARENCËS TË AGJENCISË
SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR**

Në mbështetje të neneve 4 dhe 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit institucional të Transparencës të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror (ASCKSHSH) hartuar në përputhje me Urdhërin nr.280, datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit model të Transparencës për autoritetet publike”, sipas lidhjes nr.1 , bashkëlidhur këtij urdhëri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Programi institucional i Transparencës publikohet në faqen zyrtare www.asck.gov.al në menunë “Programi i Transparencës”.
3. Ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe koordinatori për të drejtën e informimit për të bashkërenduar punën për bërjen publike në faqen zyrtare të institucionit të çdo informacioni /dokumentacioni në funksion të transparencës proaktive.
4. Urdhëri nr.32, datë 06.09.2022 “ Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Denis Gjika

